



AUTORITETI KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
DREJTORIA E RREGULLIMIT EKONOMIK

TREGUESIT STATISTIKORE
TE TREGUT TE KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

6 MUJORI I-rë 2011

TELEFONI CELULARE

TELEFONI FIKSE

INTERNET

Nentor 2011

| | |
|---|-----------|
| I.HYRJE | 3 |
| II. PANORAME E PERGJITHSHME | 4 |
| III. TELEFONIA CELULARE | 7 |
| III.1 Pjeset e tregut te operatoreve celulare | 7 |
| III.2. Trafiku telefonik | 10 |
| III.3. Perdorimi mesatar mujor i sherbimeve celulare | 10 |
| IV. TELEFONIA FIKSE | 12 |
| IV.1 Numri i pajtimtareve dhe pjeset e tregut..... | 12 |
| IV.2. Perdorimi mesatar mujor i sherbimeve te Albtelecom | 13 |
| V. INTERNETI | 15 |
| V.1. Numri i pajtimtareve me akses broadband ne Internet dhe struktura e tyre | 15 |
| V.2. Ofrimi me shumicë i aksesit në Internet dhe infrastruktura..... | 17 |

| | |
|--|----|
| Figura 1. Ecuria e numrit te perdoruesve të telefonisë celulare dhe fikse 2000-2011/1 | 5 |
| Figura 2. Ecuria e penetrimit të telefonisë celulare dhe fikse 2003-2011/1..... | 5 |
| Figura 3. Ecuria e numrit të përdoruesve celularë 2000-2011/1 | 7 |
| Figura 4. Struktura e perdoruesve te telefonise celulare (2011/1)..... | 8 |
| Tabela 1: Struktura e perdoruesve celulare 2011/1 | 8 |
| Figura 5: Pjeset e tregut te operatoreve celulare (2011/1) | 9 |
| Tabela 2: Perdorimi mesatar i sherbimeve celulare 2009-2011/1 | 11 |
| Tabele 3: Perdorimi i sherbimeve roaming nderkombetar 2010/1 dhe 2011/1 | 11 |
| Figura 6. Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2000-2011/1..... | 12 |
| Tabela 4 : Shperndarja e numrit te pajtimtareve te telefonise fikse sipas operatoreve (2011/1) | 13 |
| Tabela 5. Perdorimi mesatar mujor i sherbimeve te Albtelecom 2004-2011/1 | 13 |
| Figura 7. Struktura e thirrjeve dalese te pajtimtareve te Albtelecom 2010/1-2011/1 | 14 |
| Figura 8. Pjeset e tregut per numrin e pajtimtarëve të aksesit broadband ne Internet 2011/1..... | 16 |
| Tabela 6. Klasifikimi i pajtimtarëve me akses broadband sipas teknologjive 2010 | 17 |
| Tabela 7. Ofrimi i aksesit në Internet në nivel me shumicë 2011/1 | 17 |

I.HYRJE

AKEP, me qellim informimin e publikut, paleve te interesuara dhe te sipermarresve te tregut te komunikimeve elektronike me treguesit kryesore te ketij tregu, ne vijimesi te raporteve periodike te publikuar ne faqen e Internetit te AKEP www.akep.al ne seksionin Statistika, ka pergatitur kete raport ne te cilin publikohen treguesit kryesore te tregut per 6 mujorin e I-re 2011, si dhe ndryshimet me periodhat e meparshme.

Ky raport eshte pergatitur duke iu referuar te dhenave te derguara nga operatoret celulare, Albtelecom si dhe te dhenave te Operatoreve Alternative dhe Ofruesve te sherbimeve, sipas formulareve te Rregullores se te dhenave statistikore, te plotesuar nga sipermarresit e autorizuara nga AKEP.¹ Per shkak te ruajtjes se konfidencialitetit te te dhenave, jo te gjithe treguesit e raportuar nga operatoret publikohen nga AKEP.

Raporti ka natyre periodike dhe mund te pasurohet edhe me tregues te tjere apo informacion me te plote per operatoret alternative.

¹ Per shkak te problemeve te mos-dergimit te te dhenave apo te dhenave jo-te plota nga operatoret alternative, disa tregues per keta operatore bazohen ne vleresimet e AKEP.

II. PANORAME E PERGJITHSHME

Numri i sipërmarrësve të cilët kanë njoftuar AKEP për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike deri në fund të 6 mujorit të I-re 2011 ishte 220 në krahasim me 196 në fund të vitit 2010. Referuar “Regjistrin të Sipërmarrësve” në lidhje me njoftimin për ofrim rrjetesh/shërbimesh gjendja në fund të 6 mujorit të I-re 2011, rezulton:

- Ofrim shërbimi publik telefonik të lëvizshëm – 4 sipërmarrës, sa në vitin 2010;
- Ofrim shërbimi publik telefonik të lëvizshëm (UMTS) (3G) – 1 sipërmarrës;
- Ofrim shërbimit publik telefonik fikse (të qëndrueshëm)– 86 sipërmarrës, kundrejt 82 në vitin 2010;
- Ofrim shërbimi të aksesit në Internet – 124 sipërmarrës, kundrejt 116 në vitin 2010;
- Ofrim shërbimi me vlerë të shtuar – 46 sipërmarrës, kundrejt 43 në vitin 2010;
- Ofrim të linjave me qera – 37 sipërmarrës, sa në vitin 2010.

Gjatë 6 mujorit të I-re 2011, tregu i komunikimeve elektronike vazhdoi të rritet në segmentet e telefonisë celulare dhe të internetit, ndërsa për telefoninë vazhdon të ruhet pothuajse i njëjti trend i vitit 2010.

Në fund të 6 mujorit të I-re të 2011, numri i përdoruesve të telefonisë së lëvizshme arriti në afërsisht 4.74 milion, e cila përbën një normë penetrimi (numri i përdoruesve për 100 banorë) prej 148%², e cila është 8 pikë përqindje më e lartë se në fund-vitin 2010.

Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të 6 mujorit të I-re 2011, rezulton të jetë 330 mijë, nivel i cili përbën një reduktim me rreth 2000 pajtimtare në krahasim me 332 mijë në fund të vitit 2010. Rënia e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse është e ndjeshme tek operatori Albtelecom, i cili rezulton të ketë një rënie nga fund-viti 2010 me rreth 10 000 pajtimtare, ndërsa vihet një rritje e këtij numri tek operatorët alternativë, gjë për të cilën mund të thuhet se kemi ndërrim të rrjetit të shërbimit nga Albtelecom drejt operatorëve alternativë. Norma e penetrimit të telefonisë fikse në Shqipëri vazhdon të jetë në nivelin e 10.2%, që përbën një normë shumë të ulët në krahasim me vendet e BE (me një mesatare prej 45%) dhe vendet e rajonit.

² Numri i përdoruesve celularë i referohet numrit të kartave SIM aktive, dhe normat e larta të përdoruesve për 100 banorë shpjegohen nga mbajtja prej një individi e më shumë se 1 kartë SIM si dhe prej përdorimit të kartave SIM nga vizitorët në një vend.

Figura 1. Ecuria e numrit te perdoruesve të telefonisë celulare dhe fikse 2000-2011/1





Figura e mëposhtme paraqet ecurine e penetrimit (numri i perdoruesve per 100 banore³) të telefonisë celulare dhe fikse per periudhen 2003-2011/1, ku vihet re që telefonia fikse nuk ka pësuar ndryshime të ndjeshme për shumë vite, ndërsa është evidente rritja e telefonisë celulare.

Figura 2. Ecuria e penetrimit të telefonisë celulare dhe fikse 2003-2011/1



³ Numri i banoreve ne Shqiperi i referohet te dhenave te Instat per numrin e popullise (projeksionet e REPOBA)

Sipas të dhënave të 6 mujorit të I-re 2011, nga Altelecom dhe operatorët alternativë si dhe të dhënave të Vodafone për numrin e pajtimtareve me akses në broadband nepermjet rrjetit 3G si dhe vlerësimeve të AKEP, rezultojnë që numri i familjeve që kanë akses në Internet me bandë të gjerë (broadband) është rreth 138 mijë apo afërsisht 17 % e familjeve, ndërsa vlerësohen të jenë mbi 10.000 pajtimtarë biznesi.

Bazuar në këto të dhëna, numri i linjave broadband për 100 banorë është rreth 4.3 %, krahasuar me 3.7 % që ishte në fund të vitit 2010.

Ndarja e tregut për ofruesit e shërbimit të Internetit, ndërmjet Altelecom dhe ofruesve të tjerë të këtij shërbimi përfshirë Vodafone si ofrues nepermjet 3G (vetëm për numrin e pajtimtareve që mundeson akses në broadband nepermjet kartave modem), rezultojnë që Altelecom zotëron rreth 53 % pjesë tregu për numrin e pajtimtarëve, alternativet rreth 37 %, kurse Vodafone Albania rreth 10 %. Ndër operatorët alternativë operatori ABcom rezultojnë me numrin më të madh me rreth 20 mijë apo 14% pjesë tregu për akses broadband.


Normat e penetrimit të shërbimeve të telefonisë fikse dhe të aksesit apo linjave broadband janë shumë më të ulëta se në vendet e BE, megjithatë rritjen në aksesin broadband, ndërsa për telefoninë celulare norma e penetrimit është mbi nivelin mesatar të vendeve të BE.

III. TELEFONIA CELULARE

III.1 Pjeset e tregut te operatoreve celulare

Në fund të 6 mujorit të I-re 2011, numri i përdoruesve të telefonisë së lëvizshme arriti në afërsisht 4.74 milion, e cila përbën një normë penetrimi (numri i përdoruesve për 100 banorë) prej 148 %⁴. Numri i përdoruesve është rritur rreth 200 mijë përdorues më shumë, krahasuar me numrin e pajtimtareve të fundit të vitit 2010. Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e numrit të përdoruesve celularë në periudhën 2003-2011/1

Figura 3. Ecuria e numrit të përdoruesve celularë 2000-2011/1



Struktura e përdoruesve celularë, në përdorues me parapagim dhe me pas-pagim (kontrate), vazhdon të jetë pothuajse e qëndrueshme dhe në 6 mujorin e I-re 2011, ku numri i përdoruesve me kontratë në raport me numrin total të përdoruesve celularë, është afërsisht 8.6 %.

Ndërsa në strukturën e përdoruesve sipas secilit operator celularë, vihet re një rritje e Eagle Mobile në rreth 13.45% të përdoruesve me kontratë, kundrejt 11.6% në fund të vitit 2010 ndërsa me pak ka Plus Communication ka rreth 3.7 % të përdoruesve me kontratë, kundrejt 4.5 % që

⁴ Numri i përdoruesve celularë i referohet numrit të kartave SIM aktive, dhe normat e larta të përdoruesve për 100 banorë shpjegohen nga mbajtja prej një individi e më shumë se 1 kartë SIM si dhe prej përdorimit të kartave SIM nga vizitorët në një vend.

kishte ne fund te vitit 2010. Operoret AMC dhe Vodafone Albania vazhdojne te ruajne pothuajse te njejten strukture te pajtimtareve me kontrate si ne fund te vitit 2010.

Figura 4. Struktura e perdoruesve te telefonise celulare (2011/1)





Tabela e meposhteme paraqet te dhena per 6 mujorin e I-re 2011, mbi numrin e pajtimtareve celulare te detajuar ne abonente Familjare dhe Biznes si dhe perdoruesit e sherbimeve te aksesit ne Internet dhe pajtimtaret qe kane nderruar program tarifar brenda te njejtit operator, si dhe tregues te numrit te pajtimtareve qe kane perdorur sherbimin e portabilitetit te numrit ne rastin e largimit nga rrjeti juaj si dhe te ardhjes ne rrjetin tuaj sipas tabelës se meposhtme.

Tabela 1: Struktura e perdoruesve celulare 2011/1

| | AMC | VF-AL | EAGLE | PLUS | Total |
|--|------------------|------------------|----------------|---------------|------------------|
| Numri pajtimtareve te telefonise mobile ne total i detajuar: | 1,912,242 | 1,663,449 | 927,207 | 244173 | 4,747,071 |
| Perdorues familjare | 1,779,710 | 1,623,008 | 762,916 | 235965 | 4,401,599 |
| Perdorues biznes | 132,532 | 40,441 | 164,291 | 8208 | 345,472 |
| Numri i pajtimtareve qe perdorin rrjetin celular per akses ne internet me GPRS/EDGE | 364,340 | 308,961 | 84,433 | 74504 | 832,238 |
| Numri i pajtimtareve qe perdorin rrjetin celular UMTS (3G) | - | 111,558 | - | - | 111,558 |
| Numri i Pajtimtareve qe kane nderruar program tarifar ne rrjetin celular | 36,497 | 69,199 | 1,905 | 694 | 108,295 |
| Numri i Pajtimtareve qe kane nderruar operator (portim numri) | | | | | 14,395 |

Pjesët e tregut të operatorëve celularë janë vlerësuar në disa prej treguesve kryesorë sipas të dhënave të depozituara në AKEP, të cilat janë të paraqitura sipas tabelave grafikeve të mëposhtme dhe që përmbajnë pjesë tregu për numrin total të pajtimtareve, sipas thirrjeve dalese të klasifikuara on/net dhe off/net, sipas totalit të thirrjeve të terminuara në rrjetet e tyre si dhe numrit të SMS-ve të derguara nga pajtimtaret e rrjeteve të tyre.

Figura 5: Pjesët e tregut të operatorëve celularë (2011/1)



III.2. Trafiku telefonik

Trafiku telefonik dales ne total ne fund te 6 mujorit te I-re 2011, krahasuar me fundin e 6 mujorit te I-re 2010 ka nje rritje ne rreth 28 %. Ndersa e klasifikuar sipas thirrjeve dalese brenda rrjetit, drejt rrjeteve te tjera celulare si dhe thirrje dalese drejt rrjeteve fikse ka nje rritje respektivisht ne vlerat 30%, 1.5 % dhe 0.7 %, vlera keto te krahasuara me te dhenat e 6 mujorit te I-re 2010.

Terminimi i thirrjeve ne totalin e thirrjeve te terminuara ka nje rritje prej rreth 6 %, krahasuar me 6 mujorin e I-re 2010, ndersa terminimi i thirrjeve hyrese nga rrjetet e tjera celulare ka nje renie prej rreth 3.6 % krahasuar me 6 mujorin e I-re 2010.

Terminimi i SMS-ve ka nje rritje prej rreth 14 % krahasuar me 6 mujorin e pare 2010

III.3. Perdorimi mesatar mujor i sherbimeve celulare

Ne vijim eshte dhene nje tabele me te dhena per perdorimin mujor per perdorues celulare. Perdorimi mesatar mujor per perdorues eshte llogaritur sipas thirrjeve dalese (thirrje qe gjenerohen nga nje perdorues) dhe thirrjeve hyrese (thirrjet e marra nga nje perdorues), te matura ne minuta. Keta tregues jane llogaritur per te gjithë trafikun e gjeneruar dhe marre gjate periudhes pjestuar me numrin mesatar te perdoruesve gjate periudhes (mesatarja e numrit te perdoruesve ne fillim dhe ne fund te periudhes). Thirrjet dalese perfshijne gjithë trafikun e origjinuar nga perdoruesit celulare ndersa thirrjet hyrese perfshijne thirrjet e marra nga perdoruesit, nga rrjete te tjera dhe nga i njeti rrjet. Perdorimi mujor i SMS i referohet vetem mesazheve te derguar. Keto te dhena paraqiten ne tabelen e meposhtem per perdorimin mesatar te nje perdoruesi celular, i perlllogaritur me te dhenat e tre operatoreve celulare.

Ne 6 mujorin e I-re 2011 vihet re tendenca e rritjes se perdorimit mesatar te thirrjeve telefonike si dhe sherbimit te SMS-se.

MOU ne fund te 6 mujorit te I-re te 2011, nje perdorues celular ka kryer mesatarisht 85 minuta thirrje dalese dhe ka marre 96 minuta thirrje hyrese, duke rezultuar ne 181 minuta komunikim ne muaj (rreth 5.9% me shume se ne vitin 2010) dhe ka derguar rreth 12 SMS ne muaj (20% me shume se ne 2010).

Tabela 2: Perdorimi mesatar i sherbimeve celulare 2009-2011/1

| | 2009 | 2010 | 2011/1 |
|-----------------------------------|------|------|--------|
| Thirrje dalese ne muaj | 53 | 80 | 85 |
| Thirrje te marra (hyrëse) ne muaj | 67 | 91 | 96 |
| MOU ⁵ | 120 | 171 | 181 |
| SMS (dalëse) ne muaj | 14 | 10 | 12 |

- Roaming Nderkombetar

Tabela e meposhteme paraqet perdorimin e sherbimeve roaming per 6 mujorin e I-re 2011 dhe jane te krahasuara me te dhenat e 6 mujorit te I-re 2010 , nga te cilate vihet re se:

- Numri i aboneteve te rrjeteve Shqiptare qe kane perdorur roaming nderkombetar gjate 6 mujorit te I-re te vitit 2011 ishte rreth 404 mije , qe ndersa numri i vizitoreve (abonente te rrjeteve te huaja) qe kryejne roaming ne Shqiperi (rreth 1.46 milion). Te dy treguesit kane rritje te ndjeshme krahasuar me gjashtemujorin e pare 2010;
- Konsumi i sherbimeve gjate kohes ne roaming eshte i vogel dhe perdorimi i tyre eshte perseri me i vogel se perdorimi nga vizitoret e rrjeteve te huaja ne Shqiperi.

Tabele 3: Perdorimi i sherbimeve roaming nderkombetar 2010/1 dhe 2011/1

| | 2010/1 | 2011/1 |
|--|---------|------------------|
| Perdorimi nga pajtimtaret e rrjeteve Shqiptare i Roamingut Nderkombetar | | |
| Numri i pajtimtareve | 281,205 | 403,818 |
| Perdorimi nga pajtimtaret e rrjeteve te huaj gjate Roamingut Nderkombetar ne Shqiperi | | |
| Numri i pajtimtareve | 889,150 | 1,454,878 |

- Mesazhe MMS

Perdorimi i sherbimeve MMS eshte ne nivel shume te kufizuar me rreth **361** mije MMS te derguara dhe te marra nga abonetet gjate 6 muajve, qe perben konsum shume te vogel mujor, kundrejt reth **572** mije MMS te derguara dhe te marra ne 6 mujorin e I-re te vitit 2010. Treguesi I 6 mujorit te I-re 2011 per sherbimin e MMS-se tregon se ka nje renie te ndjeshme krahasuar me 6 mujorin e I-re 2010.

⁵ Minutes Of Use: Minuta perdorimi të matura me shumën e thirrjeve dalëse dhe hyrëse.

IV. TELEFONIA FIKSE

IV.1 Numri i pajtimtareve dhe pjeset e tregut


Telefonia fikse në ndryshim nga telefonia celulare dhe Interneti, ka pësuar ndryshime shumë të vogla në numrin e pajtimtarëve, dhe vazhdon të ketë një penetrim shumë të ulët. Në fund të 6 mujorit të I-re 2011, numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse arriti në rreth 330 mijë, nivel i cili përbën një reduktim në krahasim me rreth 332 mijë që ishin në fund të vitit 2010. Ky reduktim erdhi si rezultat i reduktimit të numrit të pajtimtarëve të Albtelecom me rreth 10 mijë abonente,

Ndërkohë në këtë periudhë ka një rritje të të numrit të pajtimtarëve nga operatorët alternativë me rreth 9 mijë pajtimtarë: nga 53 mijë në fund të vitit 2010 në rreth 62 mijë në fund të 6 mujorit të I-re 2011.

Ndryshimet e mesiperme tregojnë se gjatë vitit 2010 si dhe gjatë 6 mujorit të I-re të vitit 2011 ka pasur kalim të mundshëm të pajtimtarëve të Albtelecom tek operatorët alternativë që tregojnë se operatorët alternativë kanë arritur të konkurrojnë me Albtelecom në terma të cmimeve dhe cilësisë së shërbimeve.

Penetrimi i telefonisë fikse është rreth 10.2%, që përbën një normë shumë të ulët në krahasim me vendet e BE (me një mesatare prej 45%) dhe vendet e rajonit. Megjithatë rënien e numrit të pajtimtarëve të Albtelecom, perseri zotëron rreth 82 % të këtij tregu me rreth 268 mijë pajtimtarë ndërsa operatorët alternativë rreth 18 % me rreth 63 mijë pajtimtarë.

Figura 6. Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2000-2011/1



Sipas te dhenave Abcom, ASC, Nisatel dhe Primo jane kater operatorete alternative me te medhenj qe zoterojne rreth 60% te numrit te pajtimtareve te telefonise fikse te operatoreve alternative, e cila perben nje ritje me rreth 10 pike perqindje ndaj fund vitit 2010. Rritje me te madhe ka pasur Abcom, i cili tashme zoteron rreth 6% te totalit te telefonise fikse dhe 32% te totalit te operatorove alternative.

Tabela 4 : Shperndarja e numrit te pajtimtareve te telefonise fikse sipas operatoreve (2011/1)

| | Albtelecom | Abcom | ASC | Nisatel | Primo | OA te tjere | Total |
|-----------------------------|-------------------|--------------|------------|----------------|--------------|--------------------|--------------|
| Numri i pajtimtareve | 267,693 | 19975 | 7408 | 5900 | 3,678 | 25 260 | 329 914 |

Edhe ne 6 mujorin e I-re 2011, Albtelecom zoteron pjesë tregu mbi 70% të thirrjeve te origjinuara drejt te gjitha rrjeteve per sektorin e telefonisë fikse. Thirrjet dalëse të përdoruesve të Albtelecom janë kryesisht thirrje lokale, 75 % e tyre.

Operatorët alternativë kanë zgjeruar zonat e tyre të operimit dhe janë të përqendruar kryesisht në zonat më urbane dhe zonat rurale në afërsi të qyteteve. Struktura dhe niveli i tarifave të këtyre operatoreve është i ngjashëm me ato të Albtelecom. Një numër operatorësh alternativë ofrojnë njëkohësisht shërbime të telefonisë fikse, akses në Internet dhe TV.

Ndër operatorët alternative vecohet Abcom që ka pasur një rritje të madhe në edhe ne gjashtëmujorin e pare të vitit 2011 të numrit të pajtimtarëve me paketa dyfishe dhe tre-fishe (internet, telefoni dhe TV), duke arritur rreth 20 mijë pajtimtarë dhe duke bërë që të jetë zotërues i rreth 6 % të tregut të telefonise fikse dhe rreth 14% në akses Internet broadband.

IV.2. Perdorimi mesatar mujor i sherbimeve te Albtelecom


Ne tabelen 6, paraqiten disa tregues konsumi mujor te thirrjeve te perdoruesve te Albtelecom. Perdorimi eshte matur sipas trafikut total dalese dhe hyres (thirrje te marra perfshijne edhe thirrjet brenda rrjetit Albtelecom, lokale dhe kombetare), pjestuar me numrin mesatar te dy periudhave te fundit te perdorueve te Albtelecom. Rreshti i fundit paraqet totalin e minutave te komunikimit (Minutes of Usage-MOU) nga nje perdorues i Albtelecom, thirrje dalese dhe te marra. Nga tabela vihet re se treguesit e sherbimeve te konsumuara nga nje perdorues i Albtelecom per 6 mujorin e I-re 2011, eshte ne trend zbrites krahasuar me te njetin tregues per vitin 2010.

Tabela 5. Perdorimi mesatar mujor i sherbimeve te Albtelecom 2004-2011/1

| | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011/1 |
|-------------------------|------|------|------|------|------|------|------|--------|
| Thirrje dalese | 187 | 227 | 239 | 180 | 164 | 136 | 151 | 123 |
| Thirrje te marra | 207 | 242 | 255 | 205 | 191 | 181 | 204 | 175 |
| MOU | 394 | 469 | 493 | 386 | 355 | 317 | 356 | 298 |

Figura e mëposhtme paraqet strukturën e thirrjeve dalese të pajtimtareve të Albtelecom ku vihet re se thirrjet lokale përbejnë një pjesë të konsiderueshme të thirrjeve dalese mbi 75%, ndërsa thirrjet ndërkombetare dhe drejt rrjeteve celulare përbejnë një pjesë shumë të vogël me më pak se 10%.

Figura 7. Struktura e thirrjeve dalese të pajtimtareve të Albtelecom 2010/1-2011/1



V. INTERNETI

V.1. Numri i pajtimtareve me akses broadband ne Internet dhe struktura e tyre

Sipas të dhënave të 6 mujorit të I-re 2011, nga Albtelecom dhe operatorët alternativë si dhe të dhënave të Vodafone për numrin e pajtimtareve me akses në broadband nëpërmjet rrjetit 3G si dhe vlerësimeve të AKEP, rezultojnë që numri i familjeve që kanë akses në Internet me bandë të gjerë (broadband) është rreth 140 mijë apo afërsisht 17 % e familjeve, ndërsa vlerësohen të jenë mbi 10.000 pajtimtarë biznesi.

Bazuar në këto të dhëna, numri i linjave broadband për 100 banorë është rreth 4.3 %, krahasuar me 3.7 % që ishte në fund të vitit 2010.

Ndarja e tregut për ofruesit e shërbimit të Internetit, ndërmjet Albtelecom dhe ofruesve të tjerë të këtij shërbimi përfshirë Vodafone si ofrues nëpërmjet 3G vetëm për numrin e pajtimtareve që mundeson akses në broadband nëpërmjet kartave modem (USB/Flash Key që mundësojnë akses në kompjuter), rezultojnë që Albtelecom zotëron rreth 53 % pjesë tregu për numrin e pajtimtarëve, alternativet rreth 37 %, kurse Vodafone Albania rreth 9 %. Ndër operatorët alternativë operatori Abcom rezultojnë me numrin më të madh me rreth 20 mijë apo rreth 15% pjesë tregu për akses broadband.

Numri i pajtimtarëve (lidhjeve) broadband nëpërmjet ADSL të Albtelecom, deri në fund të 6 mujorit të I-re të vitit 2011 është rreth 73 mijë pajtimtarë nga të cilët rreth 6% të tyre janë pajtimtarë biznes, kurse të tjerët janë pajtimtarë familjare. Numri i pajtimtareve me akses në broadband për 6 mujorin e I-re 2011 të Albtelecom ka një rritje të vogël krahasuar me të dhënat e fundit të vitit 2010, prej rreth 2000 pajtimtarësh.


Teknologjia kryesore vazhdon të jetë ADSL dhe operatori kryesor është Albtelecom, i cili ka qenë shumë aktiv në shërbimet e aksesit në Internet, nëpërmjet investimeve në rrjetin lokal për të mundësuar ofrimin e shërbimit broadband nëpërmjet ADSL dhe reduktimit të tarifave për këtë shërbim. Nga të dhënat e raportuara vihet re se një numër i konsiderueshëm i lidhjeve broadband nga operatorët alternativë kryhet me kombinim fibër optike, kabëll koaksial apo linjë bakri. Ndërkohe rreth 87% e abonenteve ADSL të Albtelecom përfitojnë akses në Internet me MSAN ku lidhja nga centrali telefonik deri në kabinet është me fibër optike dhe më pas me linjë bakri, e cila mund të konsiderohet si FTTN (Fiber To The Node).

Në 6 mujorin e I-re 2011, nga operatorët celularë, është ofruar shërbimi i internetit nëpërmjet aparateve celulare dhe kartave modem për PC. Vlen të përmendet që ka një rritje të këtij numri krahasuar me të dhënat e fundit të vitit 2010, ku numri i pajtimtarëve celularë (me kontratë dhe me parapagim) me akses në Internet nëpërmjet aparatit celular me GPRS/EDGE ishte rreth 1.2 milion përdorues, ndërsa në fund të 6 mujorit të I-re 2011 është rreth 832 mijë.

Por në fund të 6 mujorit të parë 2011, rezultojnë që numri i pajtimtareve me akses në broadband 3G, të ofruar nga operatori Vodafone Albania sipas të drejtës së marre për ofrimin e këtij shërbimi nga fundi i vitit 2010, numri i pajtimtareve që përdorin shërbimet e rrjetit 3G me aparat celulare dhe karta modem është rreth 112 000, ku rreth 13 mijë prej tyre kanë akses në broadband nëpërmjet kartës modem.

Keshtu ne totalin e plote te pajtimtareve qe kane akses ne broadband ne shkalle vendi jane perfshire edhe 13 mije pajtimtare qe mundesohen nepermjet rrjetit 3G (USB/Flash Key qe mundesojne akses ne kompjuter), gje qe ne shkalle vendi ne fund te 6 mujorit te I-re 2011, sipas te gjitha teknologjive dhe per te ofruesit e sherbimit te aksesit ne broadband, numri i pajtimtareve ne total rezulton te jete rreth 140 mije.

Figura 8. Pjeset e tregut per numrin e pajtimtarëve të aksesit broadband ne Internet 2011/1



Edhe gjatë 6 mujorit te I-re vitit 2011, vazhdon i njejti trend ne lidhje me ndryshimet cilësore në ofrimin e aksesit broadband në Internet si ne gjysmen e dyte vitit 2010:

- ♦ **Rritje e shpejtësisë së aksesit në Internet broadband ADSL** nga intervali 256kbps-2mbps ne 2mbps-12mbps, ku shpejtësia minimale dhe me e perdorur eshte 2mbps.
- ♦ **Reduktim i tarifave te aksesit broadband**
- ♦ **Rritje e numrit te paketave shumefishe (double dhe triple play)**

Gjate 6 mujorit te I-re 2011, vazhdon te kete nje game te re paketash ofertuese nga ofruesit e sherbimeve te interenetit, gje e cila sjell nje reduktim te metejshem te tarifave per aksesin broadband.

Tabela 6. Klasifikimi i pajtimtarëve me akses broadband sipas teknologjive 2010

| | Alternative | Albtelecom |
|---|-----------------------|--------------------|
| Shpejtesia e akseist ne Internet | 256 kbit/s- 20 Mbit/s | 2 Mbit/s-12 Mbit/s |
| Shpejtesia me e perdorur | 1 Mbit/s | 2 Mbit/s |
| Numri i pajtimtareve qe kane akses ne sherbime te integruara: | | |
| Internet dhe Telefoni | 26655 | 72,943 |
| TV, Internet dhe Telefoni | 2007 | 0 |

V.2. Ofrimi me shumicë i aksesit në Internet dhe infrastruktura

Në tabelën e mëposhtme paraqiten disa të dhëna për ofrimin e aksesit në Internet në nivel me shumicë (ofrimi per Hotspot, Internet kafe dhe lidhja me Boten) si dhe infrastrukturën e ndërtuar nga operatorët Alternative dhe Albtelecom. Nga të dhënat vihet re se konektiviteti me Internetin Global është rritur nga rreth 14 Gbps ne fund te vitit 2010 ne rreth 17 Gbps ne fund te gjashtemujorit te pare 2011. Nderkohe me rritje paraqitet edhenuri i Internet kafeve qe marrin akses nga ISP-te, nga rreth 1000 për vitin 2010, ne rreth 1100, nderkohe nuk ka ndryshim per pikat Wi-Fi Hot Spots.

Tabela 7. Ofrimi i aksesit në Internet në nivel me shumicë 2011/1

| | Alternative | Albtelecom | Total |
|--|--------------------|-------------------|--------------|
| Numri i pikave publike Wireless (WLAN apo WiFi Hotspots) | 1400 | 0 | 1400 |
| Numri i Internet Kafe | 583 | 533 | 1116 |
| Konektiviteti me Internetin Global (nderkombetar) | 6.2 Gbps | 11 Gbps | 17.2 Gbps |
| Fibër Optike e instaluar (gjatesia km) | 1395 | 1530 | 2925 |